



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
SARANDË**

**VENDIM**

**(për shpalljen fitues për pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë  
pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Sarandë)**

Komisioni i pranimi i përbërë nga Lixhers Mali, Altin Avduli dhe Ketrina Veizi, caktuar me urdhrin “Për ngritjen e komisionit të pranimi dhe nisjen e procedurave për emërimin e disa punonjësve” të Zëvendës drejtuesit të Prokurorisë datë 12.09.2025, në përfundim të procedurës së konkurimit për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “sekretar pranë prokurorëve” në kategorinë iv-1, në mbështetje dhe në zbatim të neneve 70 – 83 e vijues të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi bëri renditjen përfundimtare të kandidatëve si më poshtë:

- Dhimitër Kreku në total 55 (pesëdhjetë e pesë) pikë.
- Armanda Buzheri në total 72 (shtatëdhjetë e dy) pikë.

**VENDOSI:**

1. Shpalljen fitues të **znj. Armanda Buzheri** në pozicionin “sekretar pranë prokurorëve” në kategorinë iv-1, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Sarandë.
2. Ky vendim, i vihet në dispozicion Zëvendës drejtuesit të Prokurorisë, si autoriteti kompetent për emërimin e nëpunësit civil në Prokurori dhe publikohet në këndin e njoftimeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
3. Kundër këtij vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.

**KOMISIONI I PRANIMIT**

**LIXHERS MALI**

**KETRINA VEIZI**

**ALTIN AVDULI**